

VASIL KOÇI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-1  
K 77

KUR ZË  
NË GOJË  
EMRIN TËND


POEZI

8JH-1  
K-22

# VASIL KOÇI

KUR ZË  
ZË GOJË  
EMRIN TËND

POEZI



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72  

---

KOMBINATI POLIGRAFIK - Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1979

## KËNGË PËR VENDLINDJEN

Nënët dhe gjyshet tona kurrë s'na kanë treguar përralla dhe legjenda për burime dhe përbindsha, për të rinj e të reja që ata gllabëronin. Ato, së bashku me vitet, na tregojnë për agallarët dhe bejlerët, që mbi postiqë delesh rrinin pranë çezmave dhe tok me tespijet e tyre numëronin edhe florinjtë. Përpara këmbëve të tyre nënët tona hidhnikëndrrat, shpresat, vitet e kockat e djemve dhe burrave të tyre, që i kishin lënë diku në Australi, në Argjentinë, e larg në Amerikën e Veriut. Dhe në mbrëmje vonë, kur ktheheteshin në shtëpi

me bucelën ngarkuar,  
të dukeshin sikur mbartnin në kurriz  
agoninë e tyre shekullore për një gllënjkë ujë,  
sikur mbartnin  
vetë jetën e tyre të martirizuar!  
Dhe e ruanin atë bucelë me ujë  
në një qoshe, të paprekur, si dritën e syve...  
Burrat e vendlindjes sime  
shijonin para kohe bukën e huaj.  
Dhe nënënat tona mbeteshin duarboshe e pakrahë,  
shtëpitë pa mbështetje!  
Dhe atëherë gjithë peshën e shtëpisë e të jetës  
e mbanin nënënat,  
gjyshet e motrat në supet e tyre.  
Nënënat tona,  
pasi lodheshin, duke pritur vite të tëra  
burrat e tyre,  
shpërthenin në vaje,  
kurse motrat,  
që rronin me të vetmin kujtim që i lidhnin në gisht  
të fejuarit,  
visheshin me të zeza  
dhe me këngët e tyre mallkonin kurbetin,  
që i mashtronte dhe u mbante larg të dashurit e tyre

2.

Kur përmendja emrin tënd, Dropull,  
tërë qenia ime mbushej me urrejtje e zemërim  
dhe humbisja në etjen tënde të pashuar!

Tani këtu,

ngado që të vete,

ngado që të shkoj,

më shoqërojnë vargjet e njohura:

— Mijëra vjete, dropullite, prisje ujë,

që shpërtheu nga zemrat e njerëzve,

e fshiu një herë e mirë

lotët, vajet, lutjet e rrënkimet e parrëfyera.

Në djall të vesh tani, ti, Skotini,

që ke gllabëruar, pa u ngopur,

vajza të reja

e nuse të bukura

Tek ty rreshtoheshin nënët e motrat tona në dimër  
me orë të tëra për një gllënjkë ujël!

Dhe kur hidhnin kovat në ujërat e tua,

ishte sikur të hidhnin zemrat e tyre të sfilitura.

Dhe nga thellësitë e tua ato nuk nxirrnin ujë

por helm e vrer,

vrer, e helm,

që ta pinin pika-pika e të mbanin në këmbë

shpirtin e tyre.

3.

Sa vjetë kaluan, Dropull, qysh atëherë,  
kur në fshatrat e tua  
u dëgjua shushurima jetëdhënëse e ujérave të

Libohovës?

Sa vjetë kaluan që gjëzimi rrjedh e lot në faqet e  
njërzëve  
pa frikë e drojtje?

Nënët, gjyshet e motrat tona atë ditë  
iu afroan çezmave me drojtje,  
hoqën shamitë e tyre të zeza nga koka,  
sikur të hiqnin nga kurrizi  
të kaluarën e tyre të nxirë,  
i mblodhën shuk dhe filluan t'i lagnin  
e pastaj të njomnin me to buzët e tyre,  
se s'u besonin syve e u dukej vetja në ëndërr,  
dhe në fund qanë nga gjëzimi, qanë,  
e me ujin u bashkuan dhe lotët e tyre.

Burrat

mbushën pëllëmbët  
dhe uronin njëri-tjetrin si t'u vinte mbarë,  
kurse ne, fëmijët,  
filluan të lozim me ujin.

Dhe ashtu siç ishin përzier të gjitha moshat  
e vitet bashkë,  
aty përpara çezmave filluan  
të heqin valle.

Tani nga kodrat e Goricës  
kundroj vendlindjen time.  
Fshatrat e saj të radhitura në faqe të malit,  
të zëna dorë për dore porsi vëllezër,  
thua se hedhin valle në sy të diellit.  
Ndërsa në sytë e mi çmboështillen,  
si ndonjë qilim shumëngjyrësh,  
fushat me të gjitha tantellat e tyre.  
Kanale të shumtë e përshkojnë kryq e tërthor!  
Nga kodrat e Goricës tani  
rrri e vështroj fushën.  
Makinat, traktoret e kombajnat  
venë e vijnë orë e çast  
dhe me zhurmën e tyre  
mbushin gjithë atmosferën,  
gjithë jetën,  
ndërsa pemët e bimët  
tundin degët e gjethet e gjelbëra  
dhe diç pëshpërisnin me flladin që zbret nga malet.

Njerëzit  
lëvrijnë si bleta në mes të arave,  
buzë kanaleve, sipër makinave,  
venë e vijnë me një shami të bardhë në kokë,  
me një lule në vesh  
e me një këngë në gojë.

Tani,

kur zë në gojë emrin tënd, Dropull,  
humbas në vreshtat, grünjërat e bostanët e tu,  
në vitet e tua të ardhshme,  
që shpalosen e valëviten në sytë e mi  
si flamuj të kuq në ditë festash,  
dhe zemra ime, shpirti im, tërë qenia ime  
mbushet me krenari të parrëfyer,  
tek të shoh me krahinat e tjera tok,  
bashkë me motrat e tua të tjera,  
që heq në gojën e ujkut pa t'u trembur syri  
vallen e lirisë,

të jetës

e të lumturisë!

## K U J T I M E . . .

Pas vitesh  
në shtëpinë time prindërore  
u ktheva përsëri.

Fëmijë isha atëherë  
që ika,  
po  
dëbora ka filluar  
të bjerë  
në flokët e mi.

Në oborr gjyshja e shtrenjtë,  
vetëm kur u gjeta dy hapa para saj  
më njohu nga zëri,  
më përqafoi dhe më shtrëngoi fort.

...Në mbledhje, në vaditje dhe në korrje  
me gjyshen shkoja, shokë.  
Që me agimin niseshim pa gdhirë,  
dhe ktheheshim në fshat me hënën  
e me yjet tok.

Dhe në ahur, kur ktheheshim në mbrëmje  
të lodhur, të dërrmuar,  
në një qoshe strukeshim me lopët —  
në fat e në mjerim të kohës të harruar.

Por dimrit, kur vjinin.  
netët e stërgjata e të rënda,  
nga dora ajo më mirrte  
e më shëtiste  
në përralla dhe legjenda.  
Vetëm ato çaste ishin për mua  
çastet më të ëmbla.

Po ja ku erdhën vitet.  
e mëdha  
të Luftës,  
dhe si ciklon u ngrit urrejtja popullore,  
filluan të dridhen  
e të shemben  
pa zhurmë përdhe sarajet.  
Në mes të fshatit doli edhe gjyshja ime

me bujqër të tjerë, asaj dite.  
Gjëmojnë akoma veshët e mi  
nga zëri i saj i ashpër,  
që përshkon kohërat dhe vitet:  
— Në kullë, para vëllezër, të vëmë zjarr,  
flaka e saj qiejt të lëpjë!  
Robërinë të djegim që na mori shpirtin,  
robërinë ta bëjmë shkrumb e hi!

Dhe përpara flakëve dhe zjarrit  
sarajet si letra gjunjëzohen.  
Tym sarajet bëhen  
dhe tok me to, në gërmadha,  
dhe vitet-shterpë kthehen!...

Në qendër të fshatit u mblodhën një mëngjes  
fshatarët e mi.  
Për herë të parë i shikoja  
të këndonin pa merak  
e të kërcenin  
me gjësim gjithë bashkë.

Shami edhe kapela fluturonin  
në ajrin vjeshtak.  
Ca pushkët  
më tutje zbrasnin.

Ndërsa gjyshja ime që nga futa nxori  
një shami të bardhë,  
një valle mori,  
Vallen e jetës  
për herë të parë  
kaq lehtë e hiqte.

## BISEDË ME GRUAN

1.

Unë tërë ditën humbisja në fushë,  
parmenda dhe qetë ishin shokët e mi,  
kurse ti  
në shtëpi rrije gjithmonë  
thëllëzë në kuvli,  
jashtë në botë s'duhej të dilje,  
të shihje dimrin, pranverën,  
bukuritë e jetës, të ndieje diellin, erën.

2.

Çdo vit e nga një fëmijë  
sillnim  
në këtë botë.

Djalë ish?

Festonim

se krah do të na bëhej në jetë,  
dhe armën mbi supet do të hidhët  
e do ta mburrnin  
dhe fushat,  
dhe malet,  
dhe pyjet  
gjoksin  
çelik do t'i tregonte kohës.  
Dhe po të ishte vajzë?  
Ajo ish «për botën»!  
Dhe kokën  
atëherë ne varnim.

3.

Katër nga dhjetë fëmijët tanë  
shpejt i varrosëm  
në dhe,  
para se të hapnin syçkat e tyre.  
Në zemrën tonë  
— plagë të hapura, të thella  
mbetën varret e tyre.  
Dikur dhe ti, në lindje e sipër,  
nga duart desh më ike.

Fëmijët u mblodhën rrëth teje  
dhe qanin, bërtisnin.  
Por ti kishe humbur  
në ethe, në dhimbje.

Nga dhimbjet,  
kur lindje, gjithnjë ulërije.  
Tri-katër plaka mblidheshin  
rrëth teje  
dhe me litarë, gërshërë, çengela  
mundoheshin  
të të çlironin.

Dhe unë te pragu i derës  
prisja në një qoshe  
me dorën në ballë,  
me kazmën dhe lopatën pranë.

#### 4.

Në jetë udhëtonim  
viktima që të dy  
Në mbrëmje vonë nga arat,  
ti dru dhe zahire mbartje,  
ndërsa me duar  
të heshtur e pa zë,  
të kohës ishim ne.  
kur ktheheshim në fshat,  
thurje papushim.

Kështu në qafën tënde mplekseshin

fije dhe litarë.

Dhe vjetët në kalim

të bëheshin

lakë e gjarpërinj.

E heshtur

dhe e ngarkuar me halle,

me kafshët tok, e dashur,  
si hije ecje në këto male.

Rënkoje e qaje shpesh

dhe fatin tënd mallkoje,

por më kot,

njeri kokën s'çante,

megjithëse ti me djersën tënde

e me mundime

shtëpinë

mbaje më këmbë.

## 5.

Të huaj, kur zaptuan vendin

dhe këmbékryq deshën në sofrën e shtëpisë

të rrinin tradhtarët,

atëherë malipherin

hodhe dhe ti në krah

e tok me mua more

rrugën e lirisë.

Por ja, armiku ish i fortë  
e nuk i binin kollaj potkonjtë.

Atéherë gjoksin i tregove.

Një ditë të ftohtë dimri  
një plumb më gđoditi  
dhe pa ndjenja më rrëzoi përdhe.  
Gjaku im rridhte si curril  
e tokën vadiste.

Por ty  
të ndjeva afër trupit tim.

Bluzën tënde shpejt e shpejt grise  
dhe plagën time lidhe  
ndaj dhe rroj ende!...

Atdheun e çliruam.

Zinxhirët i këputëm,  
që duart na plagosën.

Nga supet flakëm  
barrën shekullore,  
robërinë,

dhe fushat, malet, pyjet  
u bënë tonat përgjithnjë.

6.

Duhej vite të kalonin

gë data e 6 Shkurtit të vinte,

BIBLIOTEKA E SHTETIT  
TIRANA - ALBANIA

17 13058

që fllad i ri të davariste  
nga zemrat,  
nga mendjet tona mykun e vjetër  
e koha të rrëzonte  
të gjitha gjethet që ishin kalbur e ishin zverdhur;  
duhej vite të kalonin, që ti, e dashur,  
të ngjiteshe me mua krah për krah  
në piedestalin e Revolucionit!...

## KUR NGJITESH NË NEMËRCKË

Maj' e saj qielin e shpon,  
maj' e saj retë copton,  
ndërsa këmbët ka në tokë,  
mijra vjete, sa kjo botë!

Pa kur ulerin murlani  
e tërbohet keq tufani,  
as që tundet, as çan kokën,  
as për erën, as për kohën!

## KUR/ECËN/NËPËR/ALPE/KU

„Sa hyn në grykë brenda  
të dalin para malet.“  
Në gërxhet, në legjendat  
mëndimi shkon e ndalet.

Pastaj një zë, një zhurmë,  
vu-vu ndihet një erë.  
Mos janë vallë legjendat,  
që zbresin me poterë?!

A, jo, është zër' i alpeve,  
është era që jehon.  
Dhe malet midis tyre  
shpeshherë bisedojnë!

Dhe bisedojnë si njerëz,  
po, po, shpesh herë dhe malet,  
për trimëri, për festa,  
për luftra, dhe për halle.

Dhé malet kishin halle,  
mjerim e plagë të rënda,  
ato veç i mbështillnin  
me mjegulla legjendash.

Sa hyn në grykë brenda,  
të dalin para malet.  
Në sondat, në brezaret,  
vështrimi shkon e ndalet.

Pastaj një zë, një zhurmë,  
drejt teje po vrapon.

Dhe malet midis tyre  
gjithnjë diç bisedojnë.

Po sot ata pse flasin,  
shpesh herë çfarë tregojnë?  
Për grunjrat, për metaletë,  
që krenarin' u shtojnë!

...nëraja ie bënjoiseid ojci

Jelam odb ūtarf desqde orf oq

...atet tibq l'hommist tibq

...allud tibq oib jettut oib

## TI MË THUA, VAJZË...

Ti më thua të këndoj për lulet, për yjet,  
të thur këngë për duart e tua të buta,

të embla,

në çaste kur në Kili mijëra duar të tjera  
mbushen me plagë dhe gjakosen nga prangat e rënda.

Ti më thua t'iu këndoj flokëve të tu të artë,  
vështrimit tënd të thellë, që kaltëron,  
në çaste kur në Spanjë mijëra shikime të tjera  
rrinë e përgjojnë: po agon dashuri e tyre

apo nuk po agon?...

Ti më thua për një shtëpi të vëtmuar të shkruaj,  
që rrighet prej mëngjesit

deri në mbrëmje nga rrezet argjendare  
në çaste kur në Itali mijëra e mijëra  
e kanë dashurinë të zhveshur,

të pambrojtur

si shtëpi pa çati fare...

Jo, unë bashkë me kohën do të eci,  
hidhërimet, gjëzimet

bashkë me shokët e miqtë e mi do t'i  
ndaj,

dhe, po të duhet, për vendin tim një ditë,  
vargjet me gjak do t'i laj.

ise ët ob mëpëndëm këpënd ob ët eis  
Tëpëndëm këpëndëm këpëndëm

i't ob im e tijpi → tħoloda om iżżejjed  
iż-żgħix

## NË MAJË TË MALIT

Në majë tē një mali,  
në kthesë tē xhadesse  
na del pérpara befasisht  
një lapidar.

Në mermerin e tij tē bardhë  
lexojmë  
emrat e skalitur tē tē rënëve.

Tē heshtur lexojmë pak rreshta lakonikë  
nga një faqe e historisë së popullit tonë.

Kur largohemi,  
tē heshtur prapë,  
hedhim edhe njéherë vështrimin  
mbrapa,  
atje në lapidar,  
që tē għidhom në kujtesë  
në qënien tonë,  
tē gjitha sa pamë dhe lexuam,  
atje në majë tē malit,

në anë të xhadesë,  
midis pemëve shekullore,  
ky lapidar duket  
si një zambak i bardhë.  
Kjo lule e bardhë e heroizmit,  
— lulja më e re dhe më e vjetër  
e vendit tim!

### VARGLJE PER VJENGEN

ut qëndroj e këtij te bardha e drithrave,  
që shtrihet si endra i bardha njerëz pëllaz  
dhe që zbulonje...  
Gëz pësqirin me dëshiri  
e kohave, por i kthej,  
dëlliçmën e Vespaçovë  
Së pësqirin me Blagoditën e  
mënyrës së vjetër,  
spresa e Lapid  
që është fusha e Vjetër  
dhe që së pake rreth  
dhe pësqirat e gjel qifte  
janë ca fillë i bënduzesimë  
dë pësqirin e lirës së këto vende  
tunë qëndron e kujtime  
dhe ujku këndësuar e kultezur tine  
dhe qëndron i lirës

lirës së afise, kur ujësorit përdorin...

me qëndra të lirës poshtë të kohave.

Në këtë kohë varet gjithë denë e tatu  
Duke pësqirin e gjel qifte e pëndurinë e

## VARGJE PËR VURGUN

Së bashku me diellin  
ngjitem në Velashovë.  
Së bashku me Bistricën,  
zbres në Finiq  
dhe afër mbrëmjes  
qëndroj në Vrinë,  
duke kërkuar të gjej diçka.  
Janë ca fije të padukshme,  
që më tërheqin gjithmonë në këto vende.  
Janë disa kujtime,  
që ulen këmbëkryq në kujtesën time  
dhe dua t'i ringjall.

...Ishte ahere, kur njerëzit bridhnin  
me një torbë boshe në krahë.  
Në atë torbë varej gjithë qenia e tyre.  
Duke kërkuar të gjej gjurmët e prindërve të  
mi,

gjej jetën e tyre fatale  
dhe agoninë e tyre për një kothere bukë.

Kam ditë që bredh në Vurg,  
që bredh në të sotmen e tij:  
në grunjërat dhe orizoret,  
në ullinjtë dhe portokajtë,  
në shtëpit' e tij të bardha e dritëlara,  
që ngjajnë si èndrra të bardha nëpër pllajat,  
dhe një mbrëmje vonë,  
i lodhur, por i lumtur,  
nga bredhjet e shumta  
nëpër kohëra,  
u ula në fushën e Vrinës e të Kranesë  
të bisedoj me të ardhmen e tij  
si me vajzën time.

## FUÇIA BOSHE

Një çamarrok shkonte nëpër rrugë  
me një fuçi që menatë,  
në një dyqan ta mbushte plot  
me dhallë ose me mjaltë.

Ashtu në rrugë duke e shtyrë  
me këmbë e rrokulliste,  
me zhurmë plot e me potere  
qetësimë ajo e prishte.

Në porta dolën njerëzia  
e shpejt u mbushën udhët,  
nga zhurma që bënte fuçia  
të gjithë mbetën të shurdhër.

Kështu e kanë, o miku im,  
gjithmonë enët boshe,  
ato bëjnë zhurmë pa pushim,  
sa herë ndërrojnë qoshe...

## FRAGMENTE NGA BUTRINTI

### 1.

C'ishe ti, Ugolin,  
që erdhe në anët tonë  
me çekiçin e arkeologut në duar?  
Arkeolog,  
pushtues  
a tregtar?  
Ti erdhe andej  
nga vinin stërgjyshërit e tu,  
që mundoheshin  
të rrëmbenin lirinë e stërgjyshërve tanë,  
po  
që s'mundën kurre  
t'i mprehin si qe  
e t'i kalojnë nën «Harkun e Triumfit».  
Ti erdhe

të na rrëmbesh kulturën e historinë  
e pastaj të krekoeshë  
midis madonave  
dhe bashkë me bretkosat e tjera  
të cirreshe:  
— Ata janë njerëz  
pa histori,  
njerëz të egër!

C'ishe ti, Ugolin,  
që erdhe në këto vise  
me çekiçin e arkeologut në dorë?  
Gratë  
që mbetën pa kokë e gjinj,  
fëmijët  
që mbetën pa këmbë e duar,  
të sakatosur nga duart e tua «delikate»,  
na thanë, se ti ishe  
aventurier e kriminel!

## 2.

Për ditë vijnë këtu  
njerëz nga të gjitha anët e atdheut  
me veshje të ndryshme.  
Një i moshuar

shikon me habi një statujë  
dhe i heshtur i përkëdhel mermerin,  
duke ndier se  
ajo përkëdhelje e bashkon  
pazgjidhshmërisht me të.

Një vajzë ulet mbi një gur  
e del fotografi,  
duke dashur të marr me vete  
një kujtim.

Një tjetër

shëtit lirisht nëpër rrugë

dhe dëgjon hapat e tij.

Në ndërgjegjen e tij thellë  
dëgjon

jehonën e jetës,

që lulëzonte dikur në këtë vend.

Çfarë i shtyn që të vijnë deri këtu?

Kureshtja dhe habia?

Jo! Ata vijnë të shohin me sytë e tyre  
historinë e gjallë të të parëve tanë.

### 3.

Kur ndodhesh në Butrint  
s'të bën zemra të largohesh,  
prandaj,  
kur bëhesh gati që të shkosh,

kthen kokën mbrapa orë e çast  
dhe atëherë të duket  
sikur ngjallen  
të gjithë gurët e nekropolit  
e nga të gjitha anët të përcjellin  
stërgjyshërit e tu, që të njohën,  
me një buzëqeshje të gjërë  
e të pambaruar...

## KËNGA E ROZAFES

Lart në Rozafa ngjitem,  
një këngë befas më shkund,  
(një këngë, që në shekuj  
s'u mbyt tek ra në Bunë!)

Gjithë ditën e ndërtonin,  
ajo rrëzohej natën...  
Por më në fund një grua  
kalanë mbajti, Rozafën...

Nga thellësit' e kohës  
na vjen ky vaj, trishtim,  
rrëqethen ditët tonë,  
coptohet shpirti ynë!

Ajo nuk është këngë  
as mit e as legjendë,  
një zë qenka, një klithmë,  
që dritë donte, dritë!

## NË KALANË E ARGJIROS

Kudo që shkel këtu  
erë baruti ndiej,  
në çdo beden e mur  
sot emrin tënd gjej...

U mbushën me kufoma  
dhe muret dhe rrënimet,  
u mpleksën vite, kombe,  
gjuhë dhe emërtime.

Taboret-re të zeza  
muret shpesh rrëthonin,  
dhe zjarri, tymi, flaka  
kalanë befas shkrettonin.

Por le të derdhej gjaku,  
duronte zemra juaj,  
kalaja bëhej varr  
gjithmonë për të huaj.

...Armiqtë shahen, grinden,  
goditen dhe rënkojnë.  
Dhe prap' rrugën e kthimit  
mes flakëve kërkojnë.

Kudo që hedh vështrimin,  
heroizmin ndiej,  
në çdo beden e mur  
sot emrin tënd e gjej...

Ma jë që iu lënë që më e  
qëndroj, iu fajtja e qëndroj  
qëndroj e që më e qëndroj, e që  
i u ndauj, i u ndauj, i u

## KUR KALOJ NGA BREGDETI

Shpesh këtej, kur kaloj  
në këto gërxhe dhe gryka,  
zërin tënd, Damjan, dëgjoj,  
që gjëmon në luftra, prita.

Përmbi male midis resh  
emri yt bredh si shqiponjë,  
që andej posa rrebesh  
përmbi osmanllinj sulmon.

Osmanllinjtë, ku humbën vallë  
krejt pa nam e pa nishan?  
Grykat, gërxhet i përpinë  
e i tretën, o Damjan!

Dorën ngrë lart si bajrak  
e si shtizë që s'thyhet kurrë,  
dhe në të sharkun ti e lidhe,  
të shpalosur si flamur.

Dhe flamuri i kuq s'i flakë,  
që në luftrat valëvitej,  
ishte shpirti i shqiptarit,  
që as lidhej e as vritej!

Mal, o permbysej,  
mal, o permbysej,  
mal, o permbysej,  
mal, o permbysej.

## MAL, O PERMBI MALE

Tanët s'kishin plumba,  
s'kishin as fishekë,  
ca barut të thatë  
kishin vec në xhep.

Sërbët kishin armë,  
turqit kishin topa.  
Laku po ngushtohej,  
po përmbysej bota.

Laku po shtrëngogohej  
rrethi pak nga pak,  
kodrat, malet rrrotull  
nxirrin tym e flakë.

Befas Mic Sokoli  
pa thënë gjysmë fjalë,  
ngrihet nga llogorja  
mal, o përmbi mal!

Më një hedhje ngrihet:  
përmbi malet, mal,  
dhe përbrys legjendat,  
shekujt kockëdalë.

Shekujt e legjendat,  
mitet hedh në erë,  
sërbët, turqit, topat  
bien në humnerë!...

## **AMANETI I LUFTËTARIT**

Mirrni shpatën, djem të mi,  
mirrni shpirtin tim të ri  
edhe derisa të vdisni  
hasmin duhet që të ndiqni.

Të pabesë dhe dinakë  
janë armiqtë e dhelparakë,  
ndaj dhe ju, gjersa të rroni  
shpatën mbani dhe luftoni.

Ah, u plaka, djem të mi,  
dhe nuk mundem dot tani  
maleve të lartë të bredh  
dhe me ju hasmin të ndjek!

Shpatën time po ju jap —  
shpirtin tim që nuk u plak,  
dhe me juve prapë do jem  
në çdo gur e në çdo shkëmb!

## NË GRYKËN E DRAGOBISË

Në këto male  
si rrebesch i vërtetë,  
tek u printë në ballë  
malësorëve,  
zbriti Bajram Curri,  
me bërrucin e rëndë hedhur krahëve.  
Dhe vuri gjoksin e tij,  
jetën e tij  
për të mbyllur këtë portë,  
të mos kalonte kësaj anë  
tradhtia zogolliane.

## V A L I X H E T

(*Gjyshit tim, që vdiq në kurbet*)

Ndanë detit molusqe, alga dhe korale  
shkulma tërë natën volli.  
Në molo të nesërmen hamalli shkarkoi  
dhe dy valixhe që vaporë nga mërgimi solli.

E bija dhe djemtë e të zotit erdhën dikur,  
valixhet — qivur hapën, babanë të takonin,  
por gjetën të kyçur plaçkat e tij  
dhe s'gjetën dot trupin e plakut ta shikonin.

Vitet dhe rininë mërgimi seç i voli,  
në vend të tij të dy valixhet mbërritën,  
si dhurata dhe mandata që tregonin  
se si një shpresë, një ëndërr, një jetë larg u  
zhuritën.

## 7 PRILL '39

Në bastion ca tulla vure  
dhe një vend, o Mujo, zure.

Lart nga muret e kalasë  
mitralozi yt do flasë.

Mitralozi yt në Evropë  
do dëgjohet e në botë:

— «Me një mbret dyzet milionë  
Shqipëria po lufton!»

- Po me se luftoka, vallë?
- Me një mitraloz të çalë!

Veten Mujua urdhëron:  
— Zjarr! E «Breda» nis këndon.

— Bjeru, Mujo, të lumtë dora,  
bjeru siç u ka rënë Vlora,  
Të kujtohet më njëzetë?  
Hidhi, pra, dhe ti në det!

Dhe fashistët shih, si turmë  
plot potere, frikë e zhurmë,  
zën' bërtasin: — Mama mia!  
Ngordhi, cofi krenaria!  
Disa, brum, shtrihen përtokë,  
ca pa këmbë, ca pa kokë.

Ca të zverdhur ca të mekur,  
por të gjithë me shpirt të vdekur!

Mitralozi i Mujos hesht!...  
Italianët prap' në rresht  
víhen. Banda në fillim,  
lë një marsh e zë një himn.  
Mitraloz' i Mujos prapë  
nis këndon e tym e flakë,  
flak' e zjarr përreth shpérndan.  
Dikush qahet, dikush shan,  
dikush bie, bum, si thes,  
dikush mbytet, dikush vdes,  
dikush armën tutje flak  
e vrapon të hipë në barkë.

Nja njëqind për tokë shtrihen  
përgjithnjë që të mos ngrihen!

— Kush na shkel pa ftesë në prag,  
pabesinë e lan me gjak!

— Gjer në gju le të shkojë gjaku,  
bjeru, Mujo Ulqinaku!

— Agresorët me flamurë  
e me lule s'priten, kurrë!

— Me se priten, Mujo, vallë?

— Ja, me plumb, me plumb në ballë!

Shtatë prill tridhjet e nëntë,  
qani djema për atdhenë!

Jo, mos qani, s'duhen lotë,  
duhen armë dhe barot!

— Armët, vellezër, ku t'i gjejmë?

— Hasmit ne do t'ia rrëmbejmë,  
e me to do ta luftojmë,  
ja të vdesim, ja të rrojmö!

## FRAGMENTE NGA BOROVA

Këtu çdo gur,  
që u dogj nga kanibalizmi i nazistëve,  
çdo pemë e trung,  
që u nxi nga hordhia e hitlerianëve,  
çdo shtëpi e kasolle,  
që u shkretua  
nga urrejtja e shfrenuar e të huajve,  
çdo breg e kodër,  
që u vrenjt  
nga mynxyra e ushtarëve me kryqin e thyer  
fsheh një histori.

Vetëm këta gurë  
të rrëzuar e të copëtuar,  
këta trungje  
të djegur e të kalbur,  
këto kodra dhe pllaja të zhveshura,

shpëtuan atë ditë  
nga hordhia e nazistëve.

2.

Kaluan kaq vjet  
qysh nga 6 korriku i 1943-it,  
por koha  
s'mundi të fshijë  
nga kodrat dhe pllajat,  
nga gurët e trungjet,  
nga fytyrat dhe zemrat e njerëzve  
mynxyrën e asaj tragjedie të parrëfyer.  
Nuk mundi të mbyllë  
plagët,  
që hapi ajo tragjedi e padëgjuar.  
Plagët mbetën gjithmonë të hapura  
dhe sa herë vitet  
do të vënë gishtin në to  
do të dhembin,  
që të mos harrojnë brezat e ardhshëm  
sa gjak e sakrifica  
na duheshin  
që të fitonim lirinë  
e jetën!

## TË PAMË, REPUBLIKE!

Të pamë, Republikë,  
që bashkë me lirinë  
kërkoje  
në gërmadha,  
në male e gërxhe,  
në pllaja e fusha,  
në vite,  
të mblidhje bijtë e tu të vrarë,  
të përkuleshe  
e të shënoje emrat,  
që të mos mundnin  
t'i shuajnë vitet e kohërat,  
Në vendin që ranë  
fillove të mbledhësh  
ca gurë,  
dhe ishe sikur të mblidhje  
shpresat dhe dëshirat,  
ditët e vitet e tyre.

Sikur të mblidhje  
kockat e tyre të shpërndara.  
Më vonë,  
në vendin e tyre  
ngrite lapidarë madhështorë  
të ndërtuar me gurë e me mermér  
e në majë të tyre vure një yll,  
një yll të kuq flakë.  
Dhe nuk janë të pakta yjet e tua,  
që ndrisin rrugën tonë,  
të mos ngatërrojmë udhën!

## *PASQYRA E LËNDËS*

Këngë për vendlindjen .....	3
Kujtime .....	9
Bisedë me gruan .....	
Kur ngjitesh në Nemërçkë .....	19
Kur ecën nëpër alpe .....	20
Ti më thua, vajzë... .....	22
Në majë të mëlit .....	24
Vargje për Vurgun .....	26
Fuçia boshe .....	28
Fragmente nga Butrinti .....	30
Kënga e Rozafës .....	34
Në kalanë e Argjiros .....	36
Kur kaloj nga bregdeti .....	37
Mal, o përmbi male .....	39
Amaneti i luftëtarit .....	41
Në grykën e Dragobisë .....	43
Valixhet .....	44
7 prill '39 .....	45
Fragmente nga Borova .....	48
Të pamë, Republikë! .....	50